



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:238309

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608762

Në ankesën e

AC-I-23-0026

Paditësi

M E fshati Sh, Podujevë.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, "Energomontimi"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2955 të datës 22 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-2955 i datës 22 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 17 prill 2014, paditësi parashtroj në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN073-0080, të datës 12 mars 2014 (AL), me të cilën kërkesa e paditësit e datës 09 janar 2014 për kompensim për tre paga të pa paguara shumë prej 1,265.40 euro, ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi konsideron se është bërë shkelje e ligjit material për faktin se në ditën e privatizimit të ndërmarrjes shoqërore NSH "Enregomentimi" i është pushuar edhe marrëdhënia e punës. Më tej, paditësi pohoi se është e palogjikshme një arsyetim se kinse është parashkruar kërkesa e punëtorit, pasi që paditësi nuk ka mundur të parashtroje asnjë kërkesë para se NSH të shkoi në likuidim. Në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 28 prill 2006, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Energomontimi" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 09 janar 2014, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar dokumentet në kopje si: vendimin e kundërshtuar, librezën e punës, autorizimin për përfaqësim, njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 04 prill 2006, listë pagesën e muajit tetor, nëntor dhe dhjetor 2005 si dhe janar, shkurt mars 2006.

Me 22 prill 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për tre paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuara në Gazeten Zyrtare nr.53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka asnjë dëshmi se ai ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimin e saj ndaj parashtruesit,

andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Nga të gjitha këto arsye propozon që kërkesa për rishikim-ankesa të hedhet si e pa pranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Me 22 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-2955, ankesën e paditësit për rishikim të Aktvendimit të Autoriteti të Likuidimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, ka shfuqizuar Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN073-0080, datë 12 mars 2014, ka obliguar autoritetin e Likuidimit i AKP-së që ankuesit M E në emër të kompensimit të tre pagave të pa paguara, ti paguaj shumën prej 1,068.90 euro, ndërsa pjesën tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, e ka refuzuar si të pa bazuar. Shuma e aprovuar do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit si dhe e ka obliguar të paditurën AKP, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ka ofruara dëshmi relevante që dëshmojnë se ai ka qenë punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuara si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKM-së, e qe ishte njoftimi për ndërprerjen e punësimit. Gjithashtu njoftimi i regjistrimit të pagave dhe Libreza e punës të parashtruara nga paditësi argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i NSH-së gjer me datën e privatizimit që ishte dt. 28 prill 2006. Shkalla e I-rë po ashtu ka arsyetuar se e paditura përveç thirrjes në parashkrim të kërkesës ajo asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuara nga ana e paditësit, respektivisht nuk e ka argumentuara të kundërtën me çka paditësit do ti mohohet e drejta në kompensim e pagave. Shkalla e I-rë, me rastin e aprovimit të shumës prej 1,068.90 euro , është bazuar në listën e pagave për muajt janar, shkurt dhe mars 2006, ashtu që paditësit për muajin janar i është njohur shuma prej 361.53 euro, për muajin shkurt i është njohur shuma prej 330.16 euro, ndërsa për muajin mars i është njohur shuma prej 377.21 euro. Gjithsejtë paditësit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1,068.90 euro aq sa edhe kanë figuruar në listë pagesën e pagave për këta 3 muaj. Kërkesa tjetër nuk është e mbështetur me provat e nevojshme materialë, prandaj si e tillë është refuzuar si e pa bazuar.

Shkalla e I-rë ka konsideruar se paditësi me provat e prezantuara siç janë : librezën e punës, njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës

04 prill 2006, listë pagesën e muajit e lartcekur, ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim. Nisur nga kjo gjendje paditësi M E kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh për pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara, në shumën e aprovuar.

Me 18 janar 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2955 të datës 22 dhjetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlihet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtror kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që ajo nuk ka dorëzuar dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve nga koha kur NSH është dashur të përmbush detyrimin e tij ndaj parashtruesit. Po ashtu AKP-ja në ankesën e parashtruar konsideron se Autoriteti i Likuidimit rithekson edhe një herë se paditësi nuk e saktëson se cili Nen i Ligjit 04/LL-034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke shkelur nenin 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L033 i cili parashikon se ankesa duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L-033, ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me 15 shkurt 2024, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të cilin e konsideron si të drejtë dhe të bazuar në

ligj. Paditësi pretendon se në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike me provat e administruara nga Shkalla e I-rë dhe gjithashtu në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi me këtë parashtrësë ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi C-IV.-14-2955 i datës 22 dhjetor 2022.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren paditësi kishte dorëzuar kërkesë me datë 09 janar 2014 për kompensim për tre paga të pa paguara shumë prej 1,265.40 euro, mirëpo AL kishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka theksuar se ai me datë 28 prill 2006, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Energomontimi" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 09 janar 2014, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuara pjesërisht ankesën e paditësit, ka shfuqizuar Aktvendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN073-0080, të datë 12 mars

2014, ka obliguar autoritetin e Likuidimit i AKP-së që paditësit M E në emër të kompensimit të tre pagave të pa paguara, ti paguaj shumën prej 1,068.90 euro, ndërsa pjesën tjetër e mbetur, përtej shumës së aprovuar refuzohet si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për pagat e kërkuara nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar. Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara. Gjithashtu Shkalla e I-rë me të drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim, meqë sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1, të Shtojcës së ligjit për AKP, paditësi mjaftueshëm kishte ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ai ka qenë punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit të NSH-se "Energomontimi" dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKM-së, e që ishte njoftimi për ndërprerjen e punësimit i dt. 28 prill 2006, i cili edhe e kishte ndërprerë përshkrimin e kërkesës për paga. Duke u bazuar në këtë fakt dhe provat të cilat i ka paraqitur paditësi, Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar shumën pagave të kërkuar prej 1,068.90 euro, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së, sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 15 shkurt 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____